



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 10999 prot.

Vlorë, më 19.09 2023

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____, Datë, _____ 2023

**“PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË PËR
VITIN 2024”**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 51 , neni 54, pika dh, k, dhe në Rregulloren “Për Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë, neni 112 e në vijim, në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Strukturës Komunitare në Fshat neni 12, si dhe në Relacionin e paraqitur nga Sekretariati i Këshillit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës _____.

VENDOSI:

1. Të miratojë buxhetin e Këshillit të Bashkisë Vlorë për vitin 2024 sipas tekstit bashkëlidhur këtij projekt-vendimi.
2. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë si dhe Sekretari i Këshillit të Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Elpinqi Mërkuri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
KËSHILLI BASHKISË**

Nr. _____ prot.

Vlorë, më _____ 2023

RELACION

**“MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT
TË BASHKISË VLORË PËR VITIN 2024 ”**

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-Vendimi që po ju paraqesim lidhet me buxhetin e Këshillit të Bashkisë” përsa i përket shpenzimeve të domosdoshme për vitin 2024. Në tekstin bashkëlidhur këtë projekt-vendim janë pasqyruar shpenzimet për honoraret për këshilltarët, për Kryetarët e Fshatrave, paga e sigurimeve shoqërore për punonjësit e Sekretariatit të Këshillit, si dhe shpenzime operative dhe disa investime të domosdoshme për funksionimin normal të Administratës dhe Këshillit të Bashkisë. Theksojmë se këtë projekt-vendim e paraqesim për miratim në Këshillin e Bashkisë, në referim të nenit 113 të Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë”, sipas të cilit është parashikuar që Këshilli i Bashkisë voton buxhetin e Këshillit të Bashkisë dhe ja paraqet Administratës së Bashkisë për ta bërë pjesë të Buxhetit Vjetor të Bashkisë Vlorë.

Sikurse theksuam më lartë, në tekstin që shoqëron projekt-vendimin janë pasqyruar në mënyrë të detajuar gjithë shpenzimet e vlerësuara të domosdoshme.

Pavarësisht sa më lartë, Këshilltarët mund të propozojnë ndryshime, paksime ose shtesa të cilat mund të bëhen pjesë e këtij buxheti.

Nga sa më lartë, propozojmë të miratoni këtë projekt-vendim me qëllim që ti përcillet Administratës së Bashkisë e cila aktualisht është duke realizuar procedurat përkatëse për hartimin dhe miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2024.

KRYETARE

Elpinqi Mërkuri



Buxheti I Këshillit të Bashkisë Vlorë për Vitin 2024

NR.	EMËRTIMI I SHPENZIMEVE	NUMRI	SIGURACIONET SHOQËRORE	PAGA MUJORE	VLEFTA VJETORE
1	Honorare për Këshillin(1/10 e pagës së kryetarit)	51		18,500	11,322,000
2	Kryetarët e Fshatrave(Kryepleqtë)	36		9,500	4,104,000
3	Sekretari i Këshillit, pagë, sigurime shoqërore	1	18,704	112,000	1,568,448
4	Specialist Arkive, pagë, sigurime shoqërore	1	13,026	78,000	1,092,312
5	Specialist marrëdh. Public, pagë, sigurime shoqërore	1	12,191	73,000	1,022,292
	TOTALI I PAGAVE E HONORAREVE				19,109,052
6	Botime periodike(raporti vjetor i veprimtarisë së këshillit, Gazeta juridike e Këshillit, fletëpalosje)				130,000
7	Fushatë Këshillimi me qytetarët				180,000
8	Botime të tjera: Përmbledhje 4 vjecare e vendimeve të Këshillit				150,000
9	Blerje karta urimi për ftesat zyrtare				25,000
10	Dërgim me postë i dokumenteve, shkresave të Këshillit dhe Këshilltarëve				12,000
11	Kancelari për zyrë				140,000
12	Mirëmbajtje pajisje kompjuterike				30,000
13	Kompjuter zyre (3 copë)				360,000
14	Printer (3 copë)				120,000
15	Rafte				150,000
16	Vizita studimore të Këshilltarëve				900,000
17	Trajnime për Këshilltarëve				200,000
18	Njoftime Televizive				4,800,000

19	Fotokopje të ndryshme				200,000
20	Shpenzime për mbledhjet e Këshillit				50,000
	Total Shpenzime operative zyre KB				7,447,000
12	Shpenzime të paparashikuara (kontigjencë -2% e totalit)				534,762
	TOTALI I SHPENZIMEVE				27,090,814

Buxheti i Këshillit Bashkiak Vlorë i detajuar sipas zërave dhe në %

Zërat e shpenzimeve	Shuma/leke (600)	Investimet 231	Shp. Operative 602	Fondi i Kontigjencës 609	TOTALI	%
Honorare Këshilli Bashkiak			11,322,000		11,322,000	42
Kryetarët e fshatrave (kryepleqtë)			4,104,000		4,104,000	15
Totali Honorare			15,426,000		15,426,000	57
Paga, sigurime	3,683,052				3,683,052	14
Shpenzime operative			6,617,000		6,617,000	24
Investime		830,000			830,000	3
Fond Kontigjence				534,762	534,762	2
TOTALI I SHPENZIMEVE	3,683,052	830,000	22,043,000	534,762	27,090,814	100